



Republika e Kosovës – Republic of Kosovo
Komuna Hani i Elezit- Municipality of Elez Han



02/ 6137 2023

25.07.2023

Duke u bazuar në nenin 67 dhe 68 të Ligjit për Zyrtarët Publikë nr. 06/L-114, Ligjit të Punës së Republikës së Kosovës nr.03/L-212, Neni 4, neni 5 i Udhëzimit Administrativë nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Dhe në bazë të nenit 21 i Udhëzimit Administrativë Kujdesi Parësor Shëndetësor nr.04/2020 dhe në bazë të Statutit të QKMF-së nr.01/2010 të dt.20.07.2010, DSHMS në Hani i Elezit publikon këtë:

KONKURS

PËR PLOTËSIMIN E VENDIT TËPUNËS

Titulli i vendit të punës: Drejtor i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare “Dr.Menduh Kaloshi” Hani i Elezit, një (1) pozitë.

Institucioni: Komuna Hani i Elezit

Drejtoria: Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Lloji i pozitës: Nëpunës i Shërbimit Publik

Numri i Pozitave: një (1)

Titulli i mbikëqyrësit: Drejtori i DSHMS-së

Kategoria funksionale: Nivël Drejtues

Grada/Koeficienti: Klasa H-4 Koeficienti 12.5,

Kohëzgjatja e Kontratës: me kohë të caktuar (mandat 4 vjeçar)

Orët e punës: 40

Detyrat dhe përgjegjësitë:

1. Drejtori i QKMF-së është përgjegjës për të siguruar ligjshmërinë në punën e QKMF-së, si dhe për punë profesionale të QKMF-së e cila duhet të organizohet dhe të udhëhiqet në pajtim me dispozitat e këtij statuti dhe akteve tjera ligjore.
2. Drejtori i QKMF-së është përgjegjës për përkujdesje efektive në shëndetësinë parësore për të gjithë banorët e komunës së Hani i Elezit dhe përgjigjet për detyrat në vijim:
 - a) Në pajtim me politikën shëndetësore, Ligjin për Shëndetësi të Kosovës dhe strategjinë e kujdesit parësorë shëndetësorë, Drejtori i QKMF-së i propozon për miratim Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale planin e punës dhe buxhetin e QKMF-së për vitin Vijues.
 - b) Drejtori është përgjegjës për zbatimin e planit të burimeve njerëzore,
 - c) Nën mbikëqyrjen dhe autorizimin e Drejtorit të DSHMS-së, zbaton Buxhetin e QKMF-së,
 - d) Është përgjegjës për udhëheqjen e përditshme të procesit të punës në QKMF.
 - e) Vendos marrëdhënie të mira me donatorët dhe OJQ-të dhe me partnerët për zbatimin e tyre,
 - f) Mundëson zhvillimin e vazhdueshëm profesional dhe trajnimin e personelit të QKMF-së.
 - g) Vendosë mekanizmat e sigurimit të cilësisë në objektet e KPSH-së të Komunës.
 - h) Jep kontribut për zhvillimin e sistemit të informimit shëndetësorë të QKMF-së sipas standardeve të pranuar dhe siguron mbledhjen e informatave.
 - i) Avancoon punën ekipore.

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë mbaruar shkollimin universitarë dhe kanë aftësi profesionale për kryerjen e detyrave.

Aftësitë/përvoja dhe atributet e tjera që kërkohen:

Specialist i Mjekësisë Familjare.

Kandidati duhet të ketë së paku 3 vite përvojë pune në shëndetësi; Përparësi duhet tu jepet kandidatëve me përvojë në procesin e implementimit të Mjekësisë Familjare, Trajnimeve në menaxhment shëndetësorë dhe Shëndetësi publike.

Dokumentet e nevojshme:

- Dëshminë për shkollimin e mbaruar (e vërtetuar).
- Licenca e Punës (e vërtetuar).
- Dokumentin e identifikimit.
- Certifikatën mbi gjendjen shëndetësore.
- Certifikatën që nuk është nën Hetime.
- Dëshmi mbi përvojën e punës.
- Certifikatën që dëshmon njohuri nga kompjuteri dhe njohuri tjera e dëshirueshme .
- Kualifikime tjera (Trajnime).

Afati dhe mënyra e aplikimit:

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data **25.08.2023** deri **08.09.2023 (16:00)**.

Të gjithë kandidatët e interesuar aplikacionin e punësimit e marrin pranë Qendrës për Shërbime me Qytetarë në Han të Elezit kati i parë dhe të plotësuar e dorëzojnë në të njëjtin vend.

Dokumentacioni i kandidatëve të cilët nuk i plotësojnë kushtet e konkursit nuk do të shqyrtohen ndërsa në intervistë do të ftohen vetëm kandidatet nga lista e ngushtë.

Konkursi dhe rezultate shpallen në linkun: <https://konkursi.rks-gov.net> dhe në tabelën e shpalljes.



Kryetari i Komunës
Mehmet Ballazhi